



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR PËR
VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte kryer pagesa në vlerë totale prej 817,603€, në kategori ekonomike jo adekuate të shpenzimeve.
- A1 Nënvlërim i regjistrimit të pasurisë kapitale në vlerë 354,000€ si rezultat i mos regjistrimit në SIMFK të pasurisë jo kapitale “Furnizimi, instalimi dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit të trafikut ajror”.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ASHNA kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18.3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël. Po ashtu, neni 11, i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë të regjistruara në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte kryer dy pagesa në vlerë totale prej 817,603€, në kategori ekonomike jo adekuate, duke shkaktuar klasifikim jo adekuat të shpenzimeve në ASHNA. Detajet e këtyre pagesave janë prezantuar në vijim:

- Pagesat në vlerë 24,530€, ishin realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për shpenzime që sipas natyrës i takonin kategorisë së investimeve kapitale/shpronësime dhe pagave dhe mëditjeve/kompensim i tatimit në paga të stafit të kontrollorëve të trafikut ajror; si dhe
- Pagesa në vlerë 793,073€, ishte realizuar nga kategoria e investimeve kapitale për kompensimin e pagave për stafin e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kjo kishte ndodhur për shkak se në kategoritë përkatëse nuk kishin mjete të mjaftueshme për ekzekutimin e këtyre pagesave.

Ndikimi

Pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate

vështirëson realizimin e buxhetit sipas planifikimeve dhe ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke reflektuar kështu në prezantimin jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi B1 Drejtori i ASHNA-së duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të planifikohen shpenzimet drejtë apo të bëhet ridestininim i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Nënvlerësim i regjistrit të pasurive

Gjetja Neni 6 i rregullës MF nr. 01/2017 për raportim financiar nga Organizatat Buxhetore, specifikon se OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Më tutje, neni 19, pika 2 e rregullës së njëjtë, specifikon se të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të regjistrojnë vlerën e pasurive jo financiare në regjistrat kontabël sipas rregullores përkatëse për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Ne identifikuam se pasuria në vlerë 354,000€ për kontratën "Furnizimi, instalimi dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit të trafikut ajror", nuk figuronte në regjistrin e pasurisë jo kapitale në SIMFK, duke shkaktuar nënvlerësim të regjistrit për këtë vlerë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i gabimeve teknike gjatë regjistrimit të pasurisë dhe mungesës së kontrolleve për ta identifikuar dhe evituar këtë pasaktësi.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurisë, ka ndikuar në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive, duke shkaktuar prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV.

Rekomandimi A1 Drejtori i ASHNA-së duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë regjister të plotë dhe të saktë të pasurisë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 4,865,554€, pasurive jokapitale është 36,928€, si dhe e stoqeve 9,867€.

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e sistemit e-pasuria

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

ASHNA ende nuk ka arritur ta vë në përdorim sistemin "e-pasuria" për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive nën 1,000€. Në mungesë të përdorimit të këtij sistemi, ASHNA kishte evidentuar dhe zhvlerësuar pasurinë jo kapitale nën 1000€ në listat e brendshme në formën e exelit dhe të njëjtat i kishte shpalosur në PFV.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme nga ana e ASHNA-së për ta vënë në përdorim këtë sistem.

Ndikimi Mirëmbajtja manuale e të dhënave rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorim, humbje apo tjetërsim tyre.

Rekomandimi C1 Drejtori duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në përdorim sistemin e-pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet, dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

NJAB në fillim të vitit 2023 kishte operuar me Drejtorin e njësisë dhe një auditor të brendshëm. Më vonë, kjo njësi kishte funksionuar me vetëm një auditor. Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër (4) takime ku ishin diskutuar raportet e auditimit të brendshëm si dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të dala nga NJAB.

Çështja A2 - Mos përmbushje e planit të NJAB-së

Gjetja

Sipas nenit 21 pikës 2 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, njësia për auditimin e brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim. Më tutje, sipas Doracakut të Auditimit të Brendshëm, udhëheqësi i subjektit të sektorit publik mund të kërkojë që në planin e auditimit të brendshëm të inkorporojë auditime shtesë apo një fushëveprim të zgjeruar. Po ashtu, çfarëdo ndryshimi i rëndësishëm pas planifikimit duhet të aprovohet nga drejtori i NjAB-se para se të bëhen ndryshimet.

Paragrafi 3 i nenit 19 i Ligjit Nr. 06//L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike përcakton autoritetin për kryerjen e auditimit të brendshëm “Njësia e auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik mbulon të gjithë subjektin e sektorit publik, përveç organeve të vartësisë që kanë njësi të auditimit të brendshëm.”

Në planin vjetor të auditimit të NJAB-së për vitin 2023, i cili ishte aprovuar edhe nga Drejtori i ASHNA-së, ishte planifikuar kryerja e 10 auditimeve. Kjo njësi gjatë vitit kishte përfunduar tetë (8) auditime. Përderisa, auditimi ‘Sistemi i Trajnimit dhe Zhvillimit’ i planifikuar të auditohet në fillim të vitit, nuk ishte kryer pasi që Drejtori i ASHNA-së kishte kërkuar nga NjAB ta ndryshonte planin auditues lidhur me këtë temë me arsyetimin se sistemet operative mbulohen nga një auditim i veçantë nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

NjAB nuk kishte pranuar ndryshimin e këtij plani dhe pas kërkesës së parashtruar nga NjAB tek Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave kjo e fundit kishte konfirmuar të drejtën e njësisë së auditimit të brendshëm për kryerjen e këtij auditimi. Ky auditim nuk kishte filluar dhe as kryer gjatë 2023.

Me datë 26 tetor 2023, Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm ishte larguar nga puna.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një fryme konstruktive të bashkëpunimit dhe mos komunikimit efektiv në mes të Drejtorit të ASHNA dhe Drejtorit të NJAB-së.

Ndikimi Mos komunikimi efektiv në mes udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe njësisë së auditimit të brendshëm ka pasur për pasojë mos përmbushjen e plotë të planit të auditimit dhe ka pamundësuar maksimizimin e përfitimit që organizata mund ta ketë nga njësia e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi A2 Drejtori i ASHNA-së duhet të krijojë kushtet për realizimin e plotë të planit të aprovuar të auditimit, përmes së cilit ofrohet mbështetja dhe siguria e menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	7,232,550	7,571,288	6,553,155	5,521,892	5,402,833
Grante Qeveritare – Buxheti	1,732,550	2,071,288	1,740,957	1,453,001	1,172,103
Të hyrat vetanake	4,710,763	0	0	0	0
Te hyrat e dedikuara	789,237	5,500,000	4,812,198	4,068,891	4,230,730

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 338,738€. Ky ndryshim i buxhetit ishte si rezultat i vendimit të qeverisë në kategorinë paga dhe mëditje.

Në vitin 2023 ASHNA ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar ose 6,553,155€, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	7,232,550	7,571,288	6,553,155	5,521,892	5,402,833
Pagat dhe mëditjet	2,898,393	3,237,131	3,237,131	2,911,551	2,854,207
Mallrat dhe shërbimet	1,650,000	1,650,000	1,020,174	1,178,725	1,029,805
Komunalitë	162,370	162,370	104,394	92,616	84,064
Investimet Kapitale	2,521,787	2,521,787	2,191,455	1,339,001	1,434,757

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur me vendim të qeverisë për 338,738€, për shkak të mungesës së mjeteve në këtë kategori. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Realizimi në këtë kategori ishte 62% e buxhetit final, në këtë nivel të realizimit ka ndikuar mos realizimi i trajnimeve për kontrolloret e rinj të trafikut ajror, të cilët nuk ishin rekrutuar sipas planit.
- Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Shpenzimet në këtë kategori ishin 64% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për investime kapitale me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Shpenzimet në këtë kategori ishin 87% e buxhetit final për shkak të mungesës së ofertave në disa projekte të parapara dhe procesit të ankesave të cilat e kanë vonuar përfundimin e procedurave të prokurimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga ASHNA në vitin 2023 ishin 6,034,653€. Nga këto, 5,958,104€ kishin të bënin me të hyrat nga shërbimet terminale apo dhënies së shërbimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe 76,549€ të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet

Totali i të hyrave	5,500,000	5,500,000	6,034,653	5,896,169	4,645,232
Të hyrat jo tatimore	5,500,000	5,500,000	6,034,653	5,896,169	4,645,232

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të ASHNA ka rezultuar me pesë rekomandime kryesore. ASHNA kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tri (3) rekomandim janë zbatuar, një (1) rekomandim është pjesërisht i zbatuar dhe një (1) rekomandim nuk ka filluar zbatimin. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Drejtori duhet të sigurojë se para lidhjes së kontratës është bërë një vlerësim i mirë i afatit të kohëzgjatjes së saj, me qëllim që të gjitha furnizimet të bëhen brenda afatit të paraparë. Gjithashtu të kërkoj nga zyrtarët përgjegjës zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	ASHNA gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë masa duke e implementuar këtë rekomandim.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Drejtori duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të	Rekomandimi nuk është zbatuar pasi që edhe gjatë vitit	Nuk ka filluar zbatimin

		buxhetit apo të bëhet ridestininim i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.	2023 kemi identifikuar keqklasifikim të shpenzimeve.	
3.	Pasuritë	Drejtori duhet të sigurojë se pasuritë të cilat janë pranuar dhe janë në përdorim, të evidentohen në regjistrin e pasurisë si pasuri në përdorim duke aplikuar edhe shpenzimet e zhvlerësimit, me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.	ASHNA gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë masa duke e implementuar këtë rekomandim.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Drejtori duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu duhet të sigurojë se në fund të çdo viti bëhet inventarizimi i pasurisë në mënyrë që të sigurohet një gjendje e saktë dhe e drejtë e regjistrin të pasurisë.	ASHNA gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë masa duke e implementuar pjesërisht këtë rekomandim pasi që kishte formuar komisionin për inventarizim të pasurive, mirëpo gjendja me e-pasurinë mbetet e njëjtë.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Obligimet e papaguara	Drejtori duhet të siguroj se të gjitha obligimet/faturat të paguhen brenda afatit prej 30 ditëve pas pranimin të faturave.	ASHNA gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë masa duke e implementuar këtë rekomandim.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Albana Kadriu, Udhëheqëse e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mos përmbushje e planit të NJAB-së	<p>Çështja A2, rezulton të jetë kontradiktore në shpjegim, paragjyqese, e pa bazuar në fakte dhe në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga vet Zyra Kombëtare e Auditimit -ZKA dhe me Kodin e Etikës dhe Standardet e Auditimit – INTOSAI dhe si e tillë është e pa qëndrueshme dhe ASHNA nuk pajtohet me këtë gjetje. Fillimisht, ZKA në Letër angazhimin për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2023 e datës 09.10.2023, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit si dhe bazuar në mostrimin, marrëdhënia e punës së ish Drejtoreshës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk ka qenë objektiv i këtij procesi të auditimit, siç është evidentuar në gjetjen Çështja A2. Se nuk ka qenë objektiv dhe mostër e auditimit dëshkohet edhe me takimin përmbyllës ku sipas pikës 7.2.19 të Doracakut të Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë, takimi përmbyllës i auditimit, përdoret për të siguruar që raporti paraprak i auditorit, gjetjet e auditimit, përgjigja e menaxhmentit dhe versioni përfundimtar i Pasqyrave Financiare diskutohen dhe bien dakord me menaxhmentin, gjë që gjatë takimit përmbyllës, asnjëherë nuk është diskutuar Çështja A2, si pjesë e draft raportit të auditimit të ASHNA-së. Kjo çështje është vënë në theks një javë pas mbajtjes së takimit përmbyllës me kërkesë nga ZKA</p>	<p>Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, duke respektuar kodin e etikës të ZKA si dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Bazuar në këto Standarde dhe Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë, puna e Njab është njëra ndër objektivat e auditimit, për të vlerësuar funksionimin e kontrolleve të brendshme në kuadër të OB-se përkatëse. Përmbushja e planit të auditimit të brendshëm është njëri ndër testet e auditimit të jashtëm, me qëllim të marrjes së sigurisë që plani i auditimit po përmbushet, duke i mbuluar fushat me rrezik si dhe për të siguruar pavarësinë e funksionimit të njesisë së auditimit të brendshëm.</p> <p>Më tutje, bazuar në Doracakun tonë të auditimit, auditorët duhet të marrin parasysh ekzaminimin e sistemeve dhe procedurave që ekzistojnë në njësinë e auditimit të brendshëm për të siguruar që puna kryhet sipas kërkesave të standardeve. Shtojca 9 e këtij Doracaku përcakton se auditori duhet që ndër të tjera: Të marrë dhe të shqyrtojë planin vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), me qëllim që të vlerësojë nëse do të mund të merren në konsideratë rezultatet e ndonjërit nga auditimet e tyre, në mënyrë që të shmanget dyfishimi.</p>

	<p>për sqarime lidhur me çështjen e mos realizimit të auditimit të DZHT-së nga ana e NJAB-së. Me datë 16.05.2024 dhe me datë 22.05.2024 kemi dërguar sqarimet për mos realizimin e auditimit të DZHT-së.</p> <p>Gjithsesi, edhe pse Çështja A2 ka të bëjë me pajtueshmërinë, asnjë nga pohimet e ZKA-së në këtë gjetje nuk kanë të bëjnë me pikën 7.2.11 të Doracakut të Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë - Çështja e pajtueshmërisë përcakton se, “Ekipi i Auditimit që kryen auditimin financiar duhet të përmbajë interesin e tij për pajtueshmërinë në ato çështje që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në përmbajtjen dhe rezultatet e raportimit financiar”, dhe këtë e dëshmojnë edhe tri gjetjet tjera të cilat nuk kanë asnjë lidhje direkte dhe as të tërthortë me Çështjen A2.</p> <p>Çështja A2 – thekson mos përmbushjen e planit të NJAB-së, kurse Gjetja vë theksin në fillim tek pavarësia funksionale e NJAB- së në raport me strukturat tjera organizative. Këtu nuk është dëshmuar askund se ku është cenuar kjo pavarësi funksionale e NJAB-së nga strukturat tjera organizative në ASHNA, si në kryerjen e auditimeve po ashtu edhe në raportim. Edhe në raportet e Komitetit të Auditimit si organ mbështetës i NJAB-së për të siguruar pavarësi nga ndërhyrjet e menaxherëve, nuk është evidentuar cenimi i pavarësisë funksionale të NJAB-së.</p> <p>Sa i përket citimit të Paragrafit 3 të nenit 19 të Ligjit Nr. 06//L-021 për Kontrollin e Brendshëm</p>	<p>Në kohën e mbajtjes së takimit përmbyllës, çështja A2 ishte në proces të trajtimit nga departamentet përkatëse në kuadër të ZKA (departamenti i metodologjisë, zyra ligjore dhe departamenti i kontrollit të cilësisë).</p> <p>Gjetja është trajtuar nga aspekti i përmbushjes së planit të NJAB-së të aprovuar edhe nga Drejtori i ASHNA-së si dhe mos lejimi i fillimit të auditimit të planifikuar “Sistemi i trajnimit dhe zhvillimit”. Çdo ndryshim i planit të NJAB-së duhet të miratohet nga të dy palët - Drejtori i NJAB-së dhe Drejtori i ASHNA-së. Në këtë rast kjo nuk ka ndodhur.</p> <p>Mungesa e një fryme konstruktive të bashkëpunimit dhe mos komunikimit efektiv ndërmjet dy palëve ka ndikuar në mos përmbushjen e planit për të gjitha auditimet. Largimi nga puna e Drejtorit të NJAB është dhënë vetëm si informatë dhe nuk është paraqitur si shkak i saj.</p>
--	--	---

	<p>të Financave Publike, i cili specifikon qartë se NJAB nuk mbulon organet e vartësisë që kanë njësi të Auditimit të Brendshëm, mirëpo nuk ka marrë për bazë se DZHT ka Departamentin për Cilësi Siguri dhe Sigurim si njësi të veçantë të auditimit të brendshëm në ASHNA. Bazuar në Manualin e DZHT-së, Rregulloren Nr. 19/2017 që Përcakton Kërkesat Teknike dhe</p> <p>Procedurat Administrative në Lidhje me Licencat dhe Certifikatat e Kontrollorëve të Trafikut Ajror, DZHT është e certifikuar si organizatë trajnuese nga AAC, në bazë të Rregullore 19/2017 (Bashkëlidhur ne e-mail). Neni 4, par. 29, përcakton se (29) ‘organizatë trajnimi’ nënkupton një organizatë, e cila është certifikuar nga autoriteti kompetent për të ofruar një ose më shumë lloje të trajnimit. Nga ana tjetër Neni 5 par. 1, përcakton se “Republika e Kosovës emëron ose themelon një ose më shumë autoritet(ete) kompetente, me përgjegjësi të ndara, për certifikimin dhe mbikëqyrjen e personave dhe organizatave që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje. Neni 78 i Ligjit Nr.</p> <p>/L-051 për Aviacionin Civil, përcakton se “AAC-ja është Autoriteti Mbikëqyrës Kombëtar i Kosovës në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 549/2004 të 10 Marsit 2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian e cila themelon kornizën për krijimin e një qielli të vetëm Evropian (“Rregullorja Kornizë”). Në përputhje me këtë, AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë dhe rregullimin ekonomik</p>	
--	--	--

	<p>të shërbimeve të navigimit ajror. AAC-ja është e pavarur nga ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror”. Manuali i DZHT i ka përcaktuar procedurat e përmbushjes së obligimeve që dalin nga rregullorja 19/2017, ku në secilën procedurë si në faqe 13, 15, 17, 18, 19 e tutje, përcakton se “Manager of Quality, Safety and Security is responsible for carrying safety and quality audits subject to this procedure” (bashkëlidhur në email).</p> <p>Krejt këto detyrime përmbillen me Nenin 4 par 2, të Ligjit Nr. 04/L- 250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ku përcakton se “Çdo dispozitë ligjore, drejtpërdrejt e aplikueshme, e dalur nga Marrëveshja për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit do të mbizotëroj cilëndo dispozitë apo aspekt ligjor të Republikës së Kosovës që nuk është në përputhje me të”.</p> <p>Me Çështjen A2, ZKA nuk ka arritur implementimin e plote të Doracakut të Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë përkatësisht pikës 6.3.3 Njohja e entitetit dhe mjedisit të tij të kontrollit të brendshëm (SNISA 2315).</p> <p>Në theksimin e mos përmbushjes së Planit të Auditimit, ku nga 10 auditime janë realizuar vetëm 8, nuk është e kuptueshme arsyeja se pse nga dy auditimet të cilat nuk janë realizuar ZKA thekson vetëm auditimin i cili me kërkesë të udhëheqësit të SSP-së dhe me aprovim të Komitetit të Auditimit nuk është realizuar dhe nuk vë theksin fare tek mos realizimi i auditimit tjetër i cili me kërkesën</p>	
--	---	--

	<p>e Auditorit të Brendshëm dhe aprovimin e Udhëheqësit të SSP-së dhe Komitetit të Auditimit, nuk është realizuar.</p> <p>Njëkohësisht edhe te pjesa ku është përshkruar nga ana e ZKA-së se arsyeja e kërkesës së Udhëheqësit të SSP-së për mos realizim të Auditimit të DZHT-së, “se sistemet operative mbulohen nga një auditim i veçantë nga Autoriteti i Aviacionit Civil”, kjo nuk qëndron pasi që DZHT njësi të veçantë të auditimit ka Departamentin për Cilësi, Siguri dhe Sigurim brenda ASHNA-së. Shërbimet operative në ASHNA përfshirë edhe DZHT- në janë subjekt i auditimit dhe nga AAC si Organ Kombëtar i Auditimit. Për më shumë AAC si dhe shërbimet operative të ASHNA-së, përfshirë dhe DZHT- në, auditohen nga Icelandic Transport Authority - ICETRA e cila është Organ ndërkombëtar nën autoritetin e NATO-së për mbikëqyrje dhe auditim. Ky theksim i çështjes bie ndesh me kodin e etikës dhe pikën 6.3.3 të Doracakut të Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë. Edhe gjatë potencimit të ndryshimit të Planit të Auditimit, ZKA ka marr për bazë vetëm kërkesën e parashtruar nga NJAB tek NJQHAB dhe sqarimin e kësaj të fundit edhe pse NJQHAB bazuar Nenin 30 par. 3.5 të Ligjit Nr. 06//L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ka përgjegjësinë në ofrimin e konsultimeve për menaxherët dhe auditorët e brendshëm, nga ana tjetër ZKA nuk është lëshuar fare në analitikën e kërkesës, ku NJAB ka vënë në lajthitje edhe NJQHAB- në duke mos sqaruar faktin se DZHT ka njësi të</p>	
--	---	--

	<p>veçantë të brendshme të auditimit si dhe nuk ka marrë për bazë Ligjin Nr. 06//L- 021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe aktet nënligjore të tij, ku Udhëheqësi i SSP-së dhe Komiteti i Auditimit, kanë kompetencën e rishikimit dhe aprovimit të Planit të Auditimit, si dhe faktin se kërkesa për anulim të auditimit të DZHT-së i është bërë nga Udhëheqësi i SSP-së me shkrim, forme kjo e rregulluar edhe me Nenin 29.1 Detyrimi për zbatim të urdhrin sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.</p> <p>Për më shumë ZKA gjithashtu në çështjen A2, është lëshuar duke aluduar dhe supozuar se Drejtori i NJAB-së është larguar nga puna si rezultat i mungesës së një fryme konstruktive nga ana e Udhëheqësit të SSP-së. Ky supozim i pa bazuar në fakte dhe është paragjykses, për arsye se Drejtoresha e NJAB-së është larguar nga Komisioni Disiplinor për shkelje disiplinore krejtësisht jashtë theksimit të çështjes A2, dhe largimi nuk ka të bëjë aspak me gjetjen. Me këtë supozim të pasaktë, ZKA ka tejkuluar kompetencat duke ndërhyrë në pavarësinë e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Ankesave, organe këto të pavarura nga Udhëheqësi i SSP-së dhe në këtë mënyrë është cenuar edhe pavarësia funksionale e ASHNA-së. Për largimin e Drejtorit të NJAB-së nga Komisioni Disiplinor, kemi një Vendim të Komisionit të Ankesave, një Vendim të KPMSHC-së dhe një aktgjykim të gjykatës për masë të përkohshme dhe aktualisht rasti është duke u trajtuar në gjykatën kompetente. Standardi INTOSAI në pikën 3.4.7</p>	
--	--	--

	<p>përcakton se "Pa ndikuar pavarësinë e ILA-së, auditorët duhet të ushtrojnë kujdes të duhur profesional dhe maturi në zgjerimin e hapave dhe procedurave përkatëse të auditimit për veprimet e jashtëligjshme, ashtu që të mos ndërhyjnë në hetimet apo procedimet ligjore të mundshme në të ardhmen". Me çështjen A2, ZKA duke ditur se e gjithë problematika e paraqitur në këtë gjetje është në procedurë gjyqësore, prap ka vepruar në kundërshtim me pikën 3.4.7 të Kodit të Etikës dhe Standardeve INTOSAI.</p> <p>Tek përcaktimi i Ndikimit sipas çështjes A2, "se mos përmbushja e plotë e planit të auditimit ka ardhur si pasojë e mos komunikimi efektiv në mes udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe njësisë së auditimit të brendshëm", nuk qëndron, pasi që përmbushja e planit të auditimit është realizuar 100%. Ndryshimi në plan të auditimit, fillimisht ka ardhur si pasojë e kërkesës me shkrim e Udhëheqësit të SSP-së, ndërsa në rastin tjetër me kërkesën e zyrtarit të NJAB-së, që për të dy kërkesat ka pasur aprovim nga ana e USSP dhe Komitetit të Auditimit, aprovim siç është përcaktuar në Nenin 25 par. 3.3 të Ligjit Nr. 06//L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Konsiderojmë se çështja A2, si tek gjetja, ndikimi dhe rekomandimi, nuk janë të bazuara në praktikat më të mira dhe nuk janë të bazuara në praktikat e ZKA-së, pasi që gjatë hulumtimeve të raporteve të ZKA-së nuk është gjetur asnjë praktikë</p>	
--	---	--

	<p>e tillë rreth frymës së komunikimit edhe pse konsiderojmë se nuk jemi organizata e vetme e cila nuk ka përmbushur planin vjetor të auditimit në masën 100%.</p> <p>Krejt në fund, konsiderojmë se raportet personale/ kolegiale të ish Drejtoreshës së NJAB në ASHNA me zyrtaret e ZKA-së, nuk do të duhej të kenë ndikim në punën profesionale të ZKA-së. Bazuar në të lartcekurat, konsiderojmë se gjetja A2 nuk qëndron dhe si e tillë duhet të largohet nga draft raporti aktual.</p>	
--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin Çështja A2 dhe komentin për përmbajtjen e Raportit, si dhe dëshmitë do t'i bashkëlidhim me këtë letër konfirmim.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Samir Bllacaku

Drejtor i ASHNA-së

Data: 18.06.2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.